



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:115093

Datë: 21.05.2024

Numri i dokumentit: 05711116

PKR.nr.88/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - Departamenti i Krimeve të Rënda, Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Gazmend Bahtiri, me bashkëpunëtoren profesionale Albana Curri dhe procesmbajtësen Dalina Kërqeli – Abdullahu - zyrtaren ligjore, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.K., për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, me shenjën PP/I.nr.22/2024, të datës 23.04.2024, duke vendosur sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë me shenjën PP.I.nr.22/2024, datë 30.04.2024, pas përfundimit të seancës dëgjimore – publike, të mbajtur me datë 17.05.2024, në prezencën e Prokurorit të Shtetit B. Z., të akuzuarit I.K. dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit B. Ç., avokat në Prishtinë, me datë 20.05.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 21.05.2024 përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

I.K., nga i ati A. dhe e ëma B. (e vajzërisë Rr.), i lindur me datë .... në P., ku edhe jeton, me adresë: rruga “G. e Ll.”, K. e T., numër ..., me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën fillore e mesme, i martuar, punon si punëtor fizik, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

## Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

I pandehuri pa autorizim, me qëllim të shitjes apo të shpërndarjes ka poseduar substanca, të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, në atë mënyrë që, me datën 13.04.2023, rreth orës 22:00/h, njësia patrulluese e Stacionit Policor Veriu - në Prishtinë, në rrugën “O. K.”, në P., gjatë një pike kontrolli kanë ndaluar automjetin e tipit ... ngjyrë hiri me targa ....., të cilën e drejtonte pandehuri I.K., gjatë kontrollimit të i pandehuri, është gjetur 12 qese të vogla me pluhur ngjyrë hiri substancë e dyshuar narkotike e llojit heroin me përzierje me Acetaminofen (paracetamol) dhe kafeinë me peshë të përgjithshme 1.72 gram; marihuanë me përzierje me Nikotinë me peshë të përgjithshme prej 0.40 gram, një palë gërshtë, një lugë për përdorimin e narkotikeve, një mjet i metalit për përdorim të narkotikëve, një brisk, një telefon, ndërsa pas kontrollit në shtëpinë e të pandehurit me datën 15.05.2023, gjatë kontrollit në shtëpinë e të pandehurit janë gjetur një peshore elektronike, një parë gërshtë, mbështjellës (ngjitës transparent) një lugë, një anë të gërshtëve të thyera.

Me këtë ka kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71, 72 lidhur me nenet 267 paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 276, 364, 365, 368, 369, 449, 452, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme KPPRK) të akuzuarin e:

## G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) muajve dhe dënim me gjobë në shumë prej 400,00 (katërqind) euro, të cilat dënime do të ekzekutohen në afatin prej 15 ditëve, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund t'a paguaj gjobën e lartcekur, gjykata dënimin me gjobë do t'ia zëvendësojë në dënim me burgim, duke e llogaritur 20,00 (njëzet) euro, e barabartë me një (1) ditë burgim.

URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i sendeve si në vijim:

- Substanca narkotike dymbëdhjetë (12) qese të vogla me pluhur ngjyrë hiri;
- Substancë narkotike e llojit heroinë me përzierje me Acetaminofen (paracetamol) dhe kafeinë me peshë të përgjithshme 1.72 gram;
- Marihuanë me përzierje me Nikotinë me peshë të përgjithshme prej 0.40 gram;
- Një (1) palë gërshër;
- Një (1) lugë për përdorimin e narkotikeve;
- Një (1) mjet i metalit për përdorim të narkotikeve;
- Një (1) brisk;
- Një (1) telefon – Nokia, ngjyrë e zezë;
- Një (1) peshore elektronike;
- Një (1) palë gërshërë, mbështjellës (ngjitës transparent) një lugë, si dhe
- Një (1) palë të gërshërëve të thyera.

DETYROHET Policia e Kosovës – Stacioni në Prishtinë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të e bëjë asgjësimin e substancës narkotike të lartcekur.

Urdhërohet Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të merr në administrim telefonin e lartpërmendur të konfiskuar, në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Administrim të Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (Ligji Nr. 05/ L- 049).

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale - paushallit gjyqësor, të e paguajë shumën prej 50,00 (pesëdhjetë) euro dhe në emër të taksës për Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimit, shumën prej 50,00 (pesëdhjetë) euro, e gjitha këto në afatin prej 15 ditëve, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzën e nën shenjën PP/I.nr.22/2024, të datës 23.04.2024, kundër të akuzuarit I.K., për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së.

Në Gjykatën Themelore Prishtinë – Departamentin për Krime të Rënda, prokurori i shtetit ka parashtruar marrëveshje për pranimin të fajësisë, me shenjën PP.I.nr.22/2024, datë 30.04.2024, e lidhur në mes të Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, të pandehurit I.K. dhe mbrojtësit të tij B.Ç., avokat në Prishtinë, sipas të cilës gjykatës në fjalë i kanë rekomanduar që të pandehurit t'i shqiptoj dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) deri në gjashtëmbëdhjetë (16) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 250,00 (dyqind e pesëdhjetë) euro, deri në 400,00 (katërqind) euro.

Gjykata pas pranimin të marrëveshjes së lartpërmendur, ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore me datë 17.05.2024, ku në këtë seancë ka njoftuar të akuzuarin I.K. me të drejtat e tij, se ka të drejtë në gjykim të rregullt dhe nëse heq dorë nga e drejta në gjykim të rregullt, i njëjti do të shpallet fajtor dhe do të dënohet në bazë të marrëveshjes për pranim të fajësisë, e këtë pasi që gjykata të merr parasysh dispozitat relevante për shqiptimin e dënimit. I akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe pas konsultimit me mbrojtjen lidhur me veprën penale, ka mbetur në tërësi pranë marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit në seancën dëgjimore lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë ka deklaruar se mbetemi në tërësi pranë marrëveshjes për pranimin e fajësisë pasi që e njëjta është arritur me vullnetin e plotë të palëve duke pasur parasysh dispozitat e nenit 230 të KPPRK-së, duke i propozuar gjykatës që të njëjtën të e aprovojë.

Mbrojtësi i të akuzuarit I.K. – B, Ç, avokat në Prishtinë, në seancën dëgjimore lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë ka deklaruar se mbetemi në tërësi pranë marrëveshjes për pranimin e fajësisë, e ka mbështetur deklarin e të mbrojturit të tij lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë, duke e njoftuar gjykatën se marrëveshjen për pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnet të plotë dhe se është në dijeni të plotë lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës qëndrojnë dhe janë të vërteta, për këtë arsye i propozojmë gjykatës që të aprovojë marrëveshjen për pranimin e fajësisë.

I akuzuari I.K. në seancën dëgjimore lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë ka deklaruar se e mbështesë në tërësi deklarin e të mbrojturit të tij, marrëveshjen e ka lidhur pa presion dhe pa ndikim, duke kërkuar nga gjykata që të e aprovojë të njëjtën.

Gjykata pas shqyrtimit të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë të paraqitur nga Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me shenjë PP.I.nr.22/24, të datës 30.04.2024 dhe aktakuzën PP.I.nr.22/24, të datës 23.04.2024, në raport me të akuzuarin I.K. për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së, ka gjetur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij. I pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret, të cilat janë paraqitur në aktakuzë, apo me provat materiale të paraqitura për plotësimin e aktakuzës dhe të pranuar nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, si dhe me dëshmi tjera, të paraqitura nga prokurori i shtetit, aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike, dhe gjithashtu ka konstatuar se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet me aktakuzë dhe atë duke u bazuar edhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Andaj, mbi bazën e të lartpërmendurave, gjykata ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë, ka mbështetje ligjore dhe bazuar në nenin 230 paragrafët 17 dhe 20 të KPPRK-së, të njëjtën e ka pranuar dhe e ka vendosur në shkresat e lëndës.

Nga deklarimi i të pandehurit në seancën dëgjimore dhe nga marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është vërtetuar se i akuzuari me datë, kohë dhe vend si në dispozitiv të aktakuzës se ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu edhe nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale të propozuara në aktakuzë, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata gjatë seancës vendosi që të e pranojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe të akuzuarit I.K., i ka shqiptuar dënimin me burgim dhe dënimin me gjobë, duke marrë në konsideratë rrethanat lehtësuese marrëveshjen për pranim të fajësisë, ndërsa rrethana rënduese

gjeti në raport me të akuzuarin, faktin se edhe më parë ka qenë i dënuar për vepra penale, rrethanë kjo e cila vërtetohet nga Ekstrakt mbi dënimet penale E1/332/2024DEQP/KGJK, i lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 19.04.2024. Andaj, gjykata duke i vlerësuar këto rrethana dhe marrëveshjen për praninë të fajësisë shqiptoi dënim nën minimumin e paraparë ligjor në kuptim të nenit 72 par. 2 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, si në dispozitiv të aktgjykimit, me bindje se është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen e kryesit, me rrethanat e kryerjes, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, si dhe me përgjegjësinë e kryesit dhe ky dënim përveç që do të mundësojë risocializimin dhe riedukimin e kryesit, i njëjti do të ndikojë edhe tek të tjerët që të mos kryejnë vepra penale, gjegjësisht do të ndihmojë në ngritjen e vetëdijes së përgjithshme lidhur me detyrimin për respektimin e ligjit, i cili është edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së.

Vendimi mbi zëvendësimin e dënimit me gjobë në dënim me burgim, është marrë konform nenit 43 paragrafi 4 të KPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin e substancës narkotike dhe sendeve të specifikuara si në dispozitiv të aktgjykimit, është marrë konform nenit 267 paragrafi 5 të KPRK-së, lidhur me nenin 276 paragrafi 1 dhe 2, nën paragrafi 2.2 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale - paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 452 të KPRK-së, si dhe nenit 36 par. 3, pika 3.2 të Ligjit Nr. 08/L-109, për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Departamenti i Krimeve të Rënda

PKR.nr.88/2024, datë 21.05.2024

Zyrtare ligjore,  
Dalina Kërçeli - Abdullahu

Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari,  
Gazmend Bahtiri

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e pranimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për gjykatën dhe palët.